

# **MEMORANDUM MIREKUPTIMI**

## **PER PJESMARRJEN E SHOQERISE CIVILE NE Mbledhjet e Keshillit Bashkiak dhe te Komisioneve te Keshillit Bashkiak**

### **Midis**

### **Keshillit te Bashkise Korçe dhe Organizatave Jofitimpruese**

Keshilli i Bashkise Korçe dhe organizatat e shoqerise civile qe veprojne ne Bashkine Korçe ne kuader te Ligjit Organik te Organizimit dhe Funkcionimit te Pushtetit Vendor dhe ne baze te Ligjit per Informimin Publik,

Të vetëdijshtëm për rolet e përgjegjësitë që kanë për t'u shërbyer sa me mire qytetareve te Korces,

Të ndërgjegjshëm se pjesmarrja e shoqerise civile dhe te qytetareve ne organin vendim-marres te Bashkise Korçe perben nje kusht themelor per zhvillimin metejshem te pjesmarrjes qytetare si dhe kontribimit qe kjo pjesemarrje ofron per arritjen e përbushjen standarteve te kerkuara per integrimin europian,

Duke vleresuar permiresimin e cilesise se jetes per qytetaret korçare si dhe sigurimin e nje mireqeverisjeje vendore dhe me standarte europiane,

Të bindur se qeverisja e mire dhe standartet realizohet permes zbatimit efektiv te Ligjit Organik per Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Vendor ne

Republikën e Shqipërisë, dhe pjesëmarrjes publike si një e drejtë e garantuar nga ky ligj dhe nga nënshkrimi i miratimi i Konventës së Aarhusit;

Duke pranuar dhe inkurajuar më tej rolin tepër të rëndësishëm të OJF-ve për japin për komunitetin dhe për zhvillimin e tij,

biën dakort si më poshtë:

1. **Keshilli i Bashkisë Korçë** do të informojë shoqatat për mbledhjet, rendin e ditës dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhjet e Keshillit Bashkiak dhe të Komisioneve të Keshillit.
2. Shoqatat e shoqërisë civile do të marrin pjesë në mbledhjet e Komisioneve të Keshillit të Bashkisë sipas interesave që përfaqësojnë duke ofruar alternativa/ide/sugjerime për çështjet e ndryshme që do të diskutohen.
3. Keshilli i Bashkisë Korçë do të konsultohet gjithmone me këto shoqata dhe me qytetaret për këto çështjet që i ngarkon Ligji Organik i Organizimit dhe Funkcionimit të Pushtetit Vendor, nëni 35, pika 1 dhe nëni 32 pikat dhe, e, f, dhe k që konkretisht janë:
  - a) Aprovimi i buxhetit dhe amendamentet e tij
  - b) Aprovimi i ndryshimeve të pronësive ose dhënia në përdorim e pronave të bashkisë paleve të treta (uzufrukti)
  - c) Përcaktimi i tarifave lokale
  - d) Adoprimi i normave, standarteve dhe kriterëve për rregullimin dhe forcimin e funksioneve që i jepen Keshillit me ligj, si dhe mbrojtja dhe garantimi i interesit publik
4. Keshilli i Bashkisë Korçë do të marrë parasysh mendimet dhe opinionet e organizatave të shoqërisë civile në aprovimin e strategjive lokale të zhvillimit dhe monitorimin e tyre
5. Keshilli i Bashkisë Korçë do të marrë parasysh prezencën e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të drejtën e fjalës sipas procedurave që do të caktohen nga Keshilli Bashkiak në hartimin e rregullores së re të këtij Keshilli.
6. Keshilli i Bashkisë Korçë do të kërkojë opinionin e shoqatave të shoqërisë civile për të gjitha projekt vendimet që do të merren në shqyrtim nga ky Keshill.
7. Keshilli i Bashkisë Korçë do të informojë shoqatat e shoqërisë civile për të gjitha aktet që do të miratohen prej tij.

1. **Shoqatat e Shoqerise Civile** do te marrin pjese aktivisht ne mbledhjet e Keshillit Bashkiak Korçe.
2. Shoqatat e Shoqerise Civile do te marrin pjese aktivisht ne mbledhjet e Komisioneve te Keshillit Bashkiak ne baze te interesave qe ato perfaqesojne duke ofruar alternative/ide/sugjerime per çeshtje te ndryshme dhe duke synuar te ndikojne vendim-marrjen vendore.
3. Shoqatat e Shoqerise Civile do te ngrene ndergjegjesimin e Anetareve te Keshillit Bashkiak per çeshtje te ndryshme dhe do te bashkepunojne me Keshillin Bashkiak per te zbatuar nenin 35, pikat 1 dhe nenin 32 pikat dh, e, f, dhe k, te Ligjit Organik per Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Vendor.
4. Shoqatat e Shoqerise Civile do te ofrojne eksperiencen dhe ekspertizen e tyre per çeshtjet qe do te diskutohen ne Komisionet e Keshillit Bashkiak dhe ne Keshillin Bashkiak.
5. Shoqatat e Shoqerise Civile do te informojne Keshillin Bashkiak per fushen e aktivitetit te tyre, grupet e interesit me te cilat punojne, projektet dhe aktivitet e tyre.
6. Shoqatat e shoqerise civile nenshkruese ruajne te drejten te realizojne oponence dhe lobim ndaj qendrimeve te Keshillit Bashkiak qe ato i vleresojne se jane ne kundërshtim me legjislacionin dhe interesin e publikut qe ato perfaqesojne.

Ky memorandum mirkuptimi do te rinovohet, permiresohet apo dhe behen amendime te tij ne baze te marveshjes midis paleve.

Proçdura per hartimin dhe miratimin e amendimeve do te jete e njejte si ajo e ndjekur per memorandumimin.

Memorandumi hyn ne fuqi menjehere pas nenshkrimimit nga palet.

Edhe pas hyrjes ne fuqi te ketij memorandumimi çdo OJF e interesuar ka te drejte te behet pale e kesaj marveshje nepermjet aderimit duke e nenshkruar memorandumimin.

PALET

KESHILLI I BASHKISE KORCE

RRJETI I GRAVE "BARRAZI NE VENDIMMARRJE"

KRYETARI

KORDINATORJA

(KORCE-POGRADEC-LIBRAZHD)

GJERGJI PENDAVINJI

ARIANA PUPA



Dixhitalizuar nga Qendra e IP  
www.infocip.org